



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



RAPORT PERIODIK

MBI VLERËSIMIN E PËRMBUSHJES SË CAQEVË TË PËRCAKTUARA PËR 9 MUJORIN E PARË TË VITIT 2014 TË PROCESIT RREGULLATOR TË TARIFAVE 2012-2014

Periudha raportuese: Janar – Shtator 2014

DFTRR/ZRRUK

Prishtinë, Nëntor 2014

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efikiente të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë.”

Misioni

“Rregullimi efektiv, transparent i shërbimeve të ujit dhe kanalizimit, në pajtim me praktikat e mira Evropiane, të cilat sigurojnë shërbime kuantitative dhe kualitative, të qëndrueshme me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.”

PËRMBAJTA

1	Hyrje	5
2	Sfidimi i biznes planeve rregullatore	6
3	Aplikimi i inflacionit	7
4	Metodologjia e vlerësimit të caqeve	8
5.	Analiza e prodhimit, faturimit dhe konsumatorët	9
5.1	Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në m ³ dhe numrit të konsumatorëve.....	10
6.	Analiza e shpenzimeve operative	12
6. 1	Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza	13
6.2	Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza	14
6.3	Shpenzimet e energjisë elektrike	16
7.	Shumat e faturimit dhe arkëtimi në vlerë monetare	17
7.1.	Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza.....	18
7.2	Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të zeza	19
7.3.	Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza	20
7.4.	Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të zeza	21
8.	Investimet kapitale	22
8.1.	Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake.....	23
8.2.	Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale vetanake të kompanive nga investimet vetanake për 9 mujorin e parë të vitit 2014.....	26
8.3.	Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët	27
8.4.	Paraqitja grafike e të dhënave të regjistruara në kontabilitet për investimet kapitale nga donatorët gjatë 9 mujorit të parë të vitit 2014	30
9.	KONKLuzionet E RAPORTIT	31

Akronimet dhe shkurtesat

BPRR	Biznes Plane Rregullatore
KRU	Kompania Rajonale e Ujit
FE	Kompania Rajonale e Ujit “Bifurkacioni” sh.a –Ferizaj
GJA	Kompania Rajonale e Ujit “Radoniqi” sh.a – Gjakovë
GJI	Kompania Rajonale e Ujit “Hidromorava” sh.a – Gjilan
MIT	Kompania Rajonale e Ujit “Mitrovica” sh.a – Mitrovicë
PE	Kompania Rajonale e Ujit “Hidrodrini” sh.a – Pejë
PR	Kompania Rajonale e Ujit “Prishtina” sh.a – Prishtinë
PZ	Kompania Rajonale e Ujit “Hidroregjioni-Jugor” sh.a – Prizren
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NjPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
ZRRUK	Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
BRRA	Baza Rregullatore e Aseteve

1 HYRJE

Ky raport pasqyron të dhënat e performancës së shtatë (7) kompanive regjionale të shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza, me të cilën vlerësohet përmbushja e caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë të tarifave gjatë nëntë mujorit të parë të vitit 2014 dhe jep një pasqyrë të përgjithshme të sektorit për periudhën e shikuar.

Për t'u përpiluar ky raport, fillimisht janë marrë të dhënat e aprovua nga procesi tarifor 2012-2014, për nëntë (9) mujin e parë të vitit 2014, të cilat njëkohësisht paraqesin të dhënat bazë përmes të cilave vlerësohet afarizmi i të gjitha KRU-ve në Kosovë. Më pastaj, janë paraqitur të dhënat e realizuara nga KRU-të për nëntë (9) mujin e parë të vitit 2014 për krahasim me të dhënat e aprovuara nga ZRRUK. Për të pasur një pasqyrë më të qartë të zhvillimeve në sektor, në këtë raport janë paraqitur edhe të dhënat historike të cilat kanë ndodhur gjatë nëntë (9) mujorit të parë të vitit 2013.

Qëllimi i këtij raporti është:

- (i) Të jepet informacion për trendin e treguesve operativ dhe financiar të KRU-ve dhe në veçanti për shkallën e investimeve kapitale të realizuara për periudhën e shikuar kohore.
- (ii) Të krahasohen treguesit e KRU-ve me objektivat (caqet) e përcaktuara të procesit tariforë të periudhës së shikuar dhe në rast të shmangieve, t'u mundësohet KRU-ve të ndërmarrin veprime të duhura me kohë për të ndryshuar, ose korrigjuar trendët e tilla gjatë pjesës së fundit të procesit tarifor 2014 nga procesi rregullatorë 2012-2014.

Duke pasur parasysh që KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë, vepron në kushte të veçanta të operimit, pasi që ofron ujë të trajtuar me shumicë për pjesën Veriore të këtij qyteti, të dhënat e kësaj kompanie pasqyrohen për gjithë regjionin me të gjitha shërbimet që i ofron kjo kompani, duke i përfshi edhe shërbimet e furnizimit me ujë të trajtuar me shumicë të pjesës Veriore të Qytetit të tyre.

2 SFIDIMI I BIZNES PLANEVE RREGULLATORE

Edhe pse në raportin përmbyllës tarifar 2012-2014 është përshkruar në detaje mënyra se si ZRRUK ka sfiduar BPRR-t e kompanive gjatë procesit të përcaktimit të tarifave, kemi konsideruar të arsyeshme që edhe në këtë raport të bëjmë një përshkrim të shkurtër se si ZRRUK ka kërkuar nga KRU-të të jenë më eficientë në shërbimet e tyre ndaj konsumatorëve.

Parimi bazë i procesit rregullatorë ka qenë qëndrueshmëria financiare për kompanitë, që nënkupton shërbime më të mira për konsumatorët e shërbyer, të cilat shpresojmë se arrihen me tarifa të arsyeshme të cilat janë të përballueshme për t'u paguar nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve të shërbyer, sikurse që kemi përcaktuar edhe caqe sfiduese për përmirësim të performancës së përgjithshme të tyre, dhe atë:

1. ZRRUK mendon se shpenzimet operative janë shumë më të larta se sa ato do të duhej të ishin, dhe roli i tyre ngritët pasi që kanë ndikim të drejtpërdrejt në tarifa. Gjatë diskutimeve tona me disa nga përfaqësuesit e kompanive kemi kërkuar nga ta që kostot e tyre të larta t'i përafrojnë me kostot mesatare të sektorit.
2. Ne besojmë se KRU-të kanë një shkallë të lartë të humbjeve komerciale, shumë kyçje të pa ligjshme dhe faturim jo të kënaqshëm, të cilat duhet të jenë në fokus të menaxhmenteve për t'i minimizuar ato, ose sjellë në relacione optimale.
3. Edhe pse performanca në arkëtimin e të ardhurave është duke u përmirësuar, vendosmërisht jemi të mendimit se përmirësimet janë shumë të ulëta në krahasim me atë se sa ato do duhej të ishin, edhe pse ne kemi qenë të kujdesshëm për të mos qenë shumë ambicioz tek këta tregues themelorë për procesin rregullatorë 2012-2014.

Prandaj, ZRRUK do të kryej monitorimin e rregullt për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara me procesin aktual rregullator (siç po bëjmë edhe me këtë raport).

3 APLIKIMI I INFLACIONIT

Përderisa qëllimi i këtij raporti kryesisht ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifar 2012-2014, për nëntë (9) mujorin e parë të vitit 2014, dhe për të qenë vlerësimi në të sa më real, të dhënat financiare të aprovuara nga ZRRUK të paraqitura në tabelat e mëposhtme janë të përshtatura me Indeksin e Çmimeve të Konsumit në Kosovë publikuara nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës të periudhës vlerësuese.

Duhet theksuar se, të dhënat financiare të aprovuara për nëntë mujorin e parë të vitit 2014 kanë marrë për bazë çmimet e mesit të vitit 2011 (Qershor 2011 = kur IÇKK-ja ishte 121.4), ngase BPRR për procesin tarifar 2012-2014 janë dorëzuara gjatë asaj kohe.

Për këtë, të dhënat financiare të aprovuara nga ZRRUK ndryshojnë prej të dhënave financiare që gjenden në BPRR, tek secila KRU.

Të dhënat financiare të aprovuara, në këtë raport, kanë marrë për bazë të dhënat e BPRR-ve duke i shumëzuar me IÇKK 1.0508. Ky indeks është fituar duke pjesëtuar mesataren e IÇKK për nëntë mujorin e vitit 2014 (127.567) me IÇKK mesit e vitit 2011 (121.4).

Sikurse edhe u theksua më lartë, qëllimi i këtij raporti ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifar 2012-2014 gjatë nëntë mujorit të vitit 2014 duke u dhënë mundësi stafëve menaxheriale të KRU-ve me ndikua në përmirësimin e nivelit të shërbimeve dhe të performances gjer në fund të këtij viti kalendarik dhe për vitet tjera pasuese.

4 METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE

Metodologjia e vlerësimit të përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifor 2012-2014 për nëntë (9) mujorin e parë të vitit 2014, do të jetë uniforme për të gjitha kategoritë e të dhënave të realizuara nga KRU-të për periudhën e shikuar kohore.

Kjo metodologji do të pasqyrohet në tabela përkatëse për të gjitha kategoritë e të dhënave, sikurse në vijim:

- të dhënat historike të realizuara nga KRU gjatë nëntë mujorit të parë të vitit 2013,
- të dhënat e aprovuara nga ZRRUK për nëntë mujorin e parë të vitit 2014,
- të dhënat e realizuara nga KRU gjatë nëntë mujorit të parë të vitit 2014,
- përqindja krahasuese e nëntë mujorit të parë të vitit 2014 me nëntë mujorin e parë të vitit 2013,
- përqindja e realizimit të caktuar të nëntë mujorit të parë të vitit 2014, dhe
- vlerësimi përfundimtar për të dhënat e dala nga periudha e shikuar.

Përqindja krahasuese e nëntë (9) mujorit të parë të vitit 2014 me periudhën e njëjtë kohore të vitit 2013 është raporti i të dhënave të dala nga treguesit e arritur të periudhave të shikuara dhe të shumëzuar me 100.

Përqindja e realizimit të caktuar për nëntë (9) mujorin e parë të vitit 2014 del si rezultat i raportit të dhënave të përcaktuara si cak për çdo kompani veç e veç dhe sektorit në përgjithësi me të dhënat e realizuara nga KRU-të dhe të shumëzuar me 100.

Vlerësimi përfundimtar për nëntë (9) mujorin e parë të vitit 2014 i paraqitur në kolonën e fundit është vlerësim i rregullatorit, dhe identifikohet si: “Pozitiv”, “Negativ” dhe “Pa të dhëna krahasuese”.

Shkurtesa	Përshkrimi	Vlerësimi
R	E realizuar	Pozitiv
Jo e R	Jo e realizuar	Negativ
T P	Tejkaluar pozitivisht	Pozitiv
T N	Tejkaluar negativisht	Negativ
E pa K	E pa krahasueshme	Pa të dhëna krahasuese

5. ANALIZA E PRODHIMIT, FATURIMIT DHE KONSUMATORËT




Analiza në vazhdim ofron të dhëna për këto kategori operative të shërbimeve të ujit të shprehura në metër kub (m³): (I) uji i prodhuar, (II) uji i humbur apo i pa faturuar, (III) uji i faturuar, (iv) dhe numrin e konsumatorëve.



Tabela Nr. 1. Pasqyra e të dhënave sasiore për ujin e prodhuar, ujin e humbur, ujin e faturuar dhe numrin e konsumatorëve të shërbyer gjatë 9m 2013 krahasuar me të dhënat e 9m2014, caqet e përcaktuara dhe aprovuara për 9m 2014 me % krahasuese 2014/2013 dhe 2014 si dhe me vlerësimin e ZRRUK-ut

Emri i Kompanisë	Të dhënat operative	Valuta	Historike 9m 2013	Aprovuara 9m 2014	Realizuara nga KRU-të 9m 2014	% krahasuese 2014/2013	% real cak 9m2014	Vlerësi mi për 9m 2014
Prishtina (PR)	Uji i prodhuar	m ³	31,470,224	33,348,750	27,376,297	86.99%	82.09%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	15,951,561	14,009,876	13,296,493	83.36%	94.91%	R
	Uji i faturuar	m ³	15,518,663	19,338,875	14,079,804	90.73%	72.81%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	110,592	110,138	116,814	105.63%	106.06%	R
Hidroregjioni Jugor (PZ)	Uji i prodhuar	m ³	14,874,778	15,311,938	13,306,889	89.46%	86.91%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	8,892,500	9,360,449	7,884,647	88.67%	84.23%	R
	Uji i faturuar	m ³	5,982,278	5,951,489	5,422,242	90.64%	91.11%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	37,464	34,921	39,873	106.43%	114.18%	R
Hidrodrini (PE)	Uji i prodhuar	m ³	20,671,326	21,343,649	22,930,863	110.93%	107.44%	R
	Uji i humbur	m ³	14,915,583	14,352,003	16,286,813	109.19%	113.48%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	5,755,743	6,991,646	6,644,050	115.43%	95.03%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	34,044	33,992	39,990	117.47%	117.65%	R
Mitrovica (MIT)	Uji i prodhuar	m ³	12,789,781	14,655,000	14,019,301	109.61%	95.66%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	6,370,834	7,135,301	8,205,643	128.80%	115.00%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	6,418,947	7,519,699	5,813,658	90.57%	77.31%	Jo e R
	Faturimi-Jug	m ³	3,102,905	3,994,699	3,201,049	103.16%	80.13%	Jo e R
	Faturimi-Veri	m ³	3,316,042	3,525,000	2,612,609	78.79%	74.12%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	26,371	25,546	27,661	104.89%	108.28%	R
Radoniqi (GJA)	Uji i prodhuar	m ³	11,408,505	15,373,582	10,427,240	91.40%	67.83%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	6,072,775	10,376,918	5,234,250	86.19%	50.44%	R
	Uji i faturuar	m ³	5,335,730	4,996,664	5,192,990	97.32%	103.93%	R
	Konsumatorët	Nr	29,067	30,062	30,311	104.28%	100.83%	R
Bifurkacioni (FE)	Uji i prodhuar	m ³	4,520,441	4,698,202	4,792,660	106.02%	102.01%	R
	Uji i humbur	m ³	2,434,156	2,162,907	2,632,704	108.16%	121.72%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	2,086,285	2,535,295	2,159,956	103.53%	85.20%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	17,759	19,046	18,311	103.11%	96.14%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Uji i prodhuar	m ³	5,830,528	5,319,524	5,646,413	96.84%	106.15%	R
	Uji i humbur	m ³	3,232,923	2,718,458	3,306,943	102.29%	121.65%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	2,597,605	2,601,067	2,339,470	90.06%	89.94%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	22,287	20,401	23,951	107.47%	117.40%	R
SEKTORI	Uji i prodhuar	m ³	101,565,583	110,050,644	98,499,663	96.98%	89.50%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	57,870,332	60,115,911	56,847,493	98.23%	94.56%	R
	Uji i faturuar	m ³	43,695,251	49,934,733	41,652,170	95.32%	83.41%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	277,583	274,105	296,911	106.96%	108.32%	R

5.1 Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në m³ dhe numrit të konsumatorëve

Të dhënat e tabelës Nr. 1. janë paraqitur grafikisht përmes grafikoneve të cilat mundësojnë krahasimin vizual të të dhënave historike të nëntë mujorit të parë të vitit 2013 me të dhënat e aprovuara nga ZRRUK dhe të dhënave të realizuara nga KRU-të në nëntë mujorin e parë të vitit 2014.





Gjendja e sektorit të ujit në Kosovë mund të paraqitet duke shfrytëzuar **Diagramin Merimangë**. Përpos tek të dhënat operative, ky diagram do të shfrytëzohet edhe tek kategoritë tjera të të dhënave në këtë raport.

Septagrami (lakorja) me ngjyrë të kuqe (shtatë këndesh) paraqet sasinë e ujit të prodhuar nga të gjitha KRU-të në Kosovë shprehur në përqindje. Hapësira e kaltër tregon sa përqind e ujit të prodhuar faturohet. Ndërkaq, hapësira me ngjyrë të gjelbër paraqet në përqindje se sa prej ujit të prodhuar arkëtohet.

Prej këtui mund të kuptojmë se diferenca në mes të septagramit (lakores ngjyrë kuqe) dhe hapësirës me ngjyrë të kaltër paraqet ujin e humbur për çdo kompani veç e veç dhe për sektor, kurse diferenca në

mes të hapësirës së kaltër dhe hapësirës së gjelbër paraqet llogaritë e arkëtueshme–borxhet e konsumatorëve ndaj kompanive për periudhën e shikuar të vitit 2014.

Për të qenë KRU-të në gjendje të mirë financiare dhe me nivele të kënaqshme të shërbimit për konsumatorët e tyre, kompanitë duhet të ngrisin performancën e tyre në krahasim me atë që është.

6. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

Sikurse u cek edhe më lartë, gjatë procesit tarifor 2012-2014, ZRRUK ka kërkuar nga KRU-të të jenë më të kujdesshëm me shpenzimet e tyre të drejtpërdrejta operative dhe ka kërkuar që të njëjtat të ulen deri në optimumin e arsyeshëm.

Për të qenë më konsekuent në aprovimin e shpenzimeve operative të cilat kanë ndikim direkt në lartësinë e tarifës, ne kemi përdorur metodën e regresionit për ato kompani që kanë pasur shpenzime operative mbi kostot optimale mesatare të disa kompanive të vlerësuara si shpenzime të arsyeshme dhe për këtë arsye kemi konsideruar se kjo është metoda më e arsyeshme dhe më transparente për reduktimin e shpenzimeve operative të KRU-ve të cilat konsiderohen me shpenzime jo shumë racionale.

Të dhënat e shpenzimeve operative të paraqitura në këtë raport janë kategorizuar konform udhëzimeve të kontabilitetit rregullator, fillimisht duke i ndarë shpenzimet operative për ujë dhe kanalizim.

Sipas UKRR, shpenzimet operative për ujë i kemi paraqitur të ndara në tri kategori:

- shpenzimet operative në resurse dhe trajtim
- shpenzimet operative në distribuim-shpërndarje, dhe
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Ndërkaq, shpenzimet operative për ujëra të zeza, janë të ndara në 4 kategori, dhe atë:

- shpenzimet operative në grumbullimin e ujërave të zeza
- shpenzimet operative në trajtimin e ujërave të zeza
- shpenzimet operative në trajtimin e llumit
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Për detaje më të hollësishme se cilat zëra të shpenzimeve operative futen në kategoritë përkatëse, mund të konsultoheni me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator, i cili gjendet i publikuar në ueb faqen zyrtare të ZRRUK (www.wwro-ks.org).


6.1 Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza

Në këtë tabelë janë të paraqitura shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza për secilën KRU dhe sektorin, duke paraqitur shpenzimet operative historike të 9 muorit të parë të vitit 2013, ato të aprovuara nga ZRRUK si dhe ato të realizuara nga KRU gjatë 9 muorit të parë të vitit 2014, shkallën e përmbushjes së caceve në % dhe vlerësimi përfundimtar për këtë periudhë kohore.



Tabela Nr. 2 Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza në €


Emri i Kompanisë	Zërat e shpenzimeve operative	Njësia	Historike 9m 2013	Aprovuara nga ZRRUK 9m 2014	Realizuara nga KRU 9m 2014	% Krahases e 9m 2014/2013	% e real. të cakt. 9m 2014	Vlerësimi përfundimtar për 9m 2014
Prishtina (PR)	Ujë	€	5,617,981	4,234,258	5,910,635	105.21%	139.59%	TN
	Ujëra të Zeza	€	182,320	155,962	175,803	96.43%	112.72%	TN
	Totali	€	5,800,301	4,390,220	6,086,437	104.93%	138.64%	TN
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	1,988,980	1,959,259	2,052,201	103.18%	104.74%	TN
	Ujëra të Zeza	€	194,513	107,974	246,252	126.60%	228.07%	TN
	Totali	€	2,183,493	2,067,233	2,298,453	105.26%	111.18%	TN
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	1,103,456	1,213,841	1,369,559	124.12%	112.83%	TN
	Ujëra të Zeza	€	95,423	66,046	123,842	129.78%	187.51%	TN
	Totali	€	1,198,878	1,279,887	1,493,401	124.57%	116.68%	TN
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	1,365,659	1,424,727	1,282,853	93.94%	90.04%	R
	Ujëra të Zeza	€	138,043	128,955	190,529	138.02%	147.75%	TN
	Totali	€	1,503,702	1,553,682	1,473,382	97.98%	94.83%	R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	1,676,263	1,218,109	1,708,057	101.90%	140.22%	TN
	Ujëra të Zeza	€	77,276	63,285	73,935	95.68%	116.83%	TN
	Totali	€	1,753,539	1,281,394	1,781,992	101.62%	139.07%	TN
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	543,268	567,532	618,965	113.93%	109.06%	TN
	Ujëra të Zeza	€	81,408	42,025	148,449	182.35%	353.24%	TN
	Totali	€	624,676	609,557	767,413	122.85%	125.90%	TN
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	819,316	704,627	870,101	106.20%	123.48%	TN
	Ujëra të Zeza	€	78,737	59,684	86,693	110.10%	145.25%	TN
	Totali	€	898,052	764,312	956,794	106.54%	125.18%	TN
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	13,114,922	11,322,353	13,812,370	105.32%	121.99%	TN
	Ujëra të Zeza	€	847,720	623,932	1,045,502	123.33%	167.57%	TN
Totali i përgjithshëm sektorial		€	13,962,642	11,946,285	14,857,872	106.41%	124.37%	TN

Nga totali i shpenzimeve operative që kanë ndodhur gjatë 9m të parë të vitit 2014, 92.96% të shpenzimeve kanë ndodhur në shërbimin e ujit, ndërsa 7.04 % janë shpenzime të ujërave të zeza. Totali i shumës së shpenzimeve operative të realizuara për të dy shërbimet nga KRU-të gjatë 9 muorit të parë të vitit 2014 është 14,857,872€, të cilat si të tilla janë tejkaluar nga shuma e aprovuar nga ZRRUK për këtë periudhë në lartësi prej 24.37%.



6.2 Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza





Prej këtij grafikoni shihet se nga shumica e shpenzimeve të aprovuara për periudhën e shikuar të vitit 2014, vetëm KRU Mitrovica ka arritur t'i ketë brenda limiteve të përcaktuara nga Rregullatori shpenzimet e veta dhe përpjekja e KRU "Hidroregjioni Jugor" dhe "Hidrodrini" të cilat edhe pse ka tejkalime të tyre, të njëjtat janë më të përmbajtura në krahasim me shumën e shpenzimeve të aprovuara nga ZRRUK për 9 mujorin e parë të vitit 2014.

Është e ditur se kostoja e pagave për të punësuarit në të gjitha KRU-të paraqesin zërat më të larta të tyre dhe për t'i pasqyruar të njëjtat në raport me kostot tjera po i paraqesim në tabelën e më poshtme, prej nga mund të kuptojmë lehtë se cila kompani menaxhon më mirë me zërin e pagave. Pasi dihet që ky zë i kostove është më ndikuesi, sikurse po paraqesim edhe pagat mesatare për secilën kompani dhe për sektorin.

Tabela Nr. 3 Shpenzimet e pagave në raport me shpenzimet totale dhe paga mesatare për 9 mujorin e vitit 2014

Emri i Kompanisë	Totali i shpenzimeve operative të realizuara për 9 mujorin e 2014	Totali i shpenzimeve të pagave të realizuara 9m 2014	Numri i të punësuarve	Përqindja e pagave në raport me shpenzimet e realizuara	Paga mesatare mujore
	€	€	Nr	%	€/muaj
PRISHTINA	6,086,437	3,553,531	547	58.38%	721.24
HIDROREGJIONI-JUGOR	2,298,453	1,298,627	304	56.50%	475.17
HIDRODRINI	1,493,401	995,340	215	66.65%	513.59
MITROVICA	1,473,382	879,375	224	59.68%	435.98
RADONIQI	1,781,992	1,309,671	243	73.49%	599.39
BIFURKACIONI	767,413	533,764	131	69.55%	451.20
HIDROMORAVA	956,794	606,872	151	63.43%	447.55
SEKTORI	14,857,872	9,177,181	1,815	61.77%	561.67

Nga pasqyra e pagave tërheqim vërejtjen tonë për ngritjen e theksuar të mesatares së fondit të pagave në të gjitha kompanitë e sidomos nga disa sosh gjatë periudhës së shikuar të 9 mujorit të parë të vitit 2014 ne krahasim me mesataren e pagës së vitit 2013. Kjo sidomos ka të bëjë me KRU “ Prishtina” Prishtinë e cila ka realizua pagën mesatare gjatë periudhës së shikuar të 9 mujorit të parë të këtij viti në shumë prej 721.24 €/muaj, ndërsa paga mesatare vjetore e vitit 2013 ishte realizuar në shumën prej 664.00 €, ndërsa te “Hidrodrini” për periudhën e njejt nga 390.00€ gjatë vitit 2013 ne 513.00 € etj.

6.3 Shpenzimet e energjisë elektrike

Siç u pa më lartë, zëri i shpenzimeve operative për paga përbën njërin ndër zërave që ka peshën më të madhe në totalin e shpenzimeve operative. Pas këtij zëri, po aq me rëndësi, është energjia elektrike e cila njëherit përbën zërin e dytë më të rëndësishëm të shpenzimeve operative. Për këtë, rregullatori përmes tabelës vijuese ka paraqitur një tabelë ku është treguar përqindja e energjisë elektrike në totalin e shpenzimeve operative për periudhën e shikuar .

Tabela Nr. 4 Shpenzimet e energjisë elektrike në raport me shpenzimet totale gjatë 9 mujorit të parë të parë të vitit 2014 shprehur në €.

Kompania	Zërat e shpenzimeve	Shpenzimet operative	Shpenzimet e energjise elektrike	Përqindja e energjise ne raport me totalin e shpenzimeve
Prishtina	Ujë	5,910,635	1,269,369	21.48%
	Ujëra të zeza	175,803	39,259	22.33%
	Totali	6,086,437	1,308,627	21.50%
Hidroregjioni Jugor	Ujë	2,052,201	540,583	26.34%
	Ujëra të zeza	246,252	35,411	14.38%
	Totali	2,298,453	575,994	25.06%
Hidrodrini	Ujë	1,369,559	306,378	22.37%
	Ujëra të zeza	123,842	6,253	5.05%
	Totali	1,493,401	312,631	20.93%
Mitrovica	Ujë	1,282,853	212,535	16.57%
	Ujëra të zeza	190,529	33,195	17.42%
	Totali	1,473,382	245,730	16.68%
Radoniqi	Ujë	1,708,057	145,835	8.54%
	Ujëra të zeza	73,935	1,568	2.12%
	Totali	1,781,992	147,403	8.27%
Bifurkacioni	Ujë	618,965	73,035	11.80%
	Ujëra të zeza	148,449	18,259	12.30%
	Totali	767,413	91,294	11.90%
Hidromorava	Ujë	870,101	149,949	17.23%
	Ujëra të zeza	86,693	223	0.26%
	Totali	956,794	150,172	15.70%
Totali i sektorit	Ujë	13,812,370	2,697,684	19.53%
	Ujëra të zeza	1,045,502	134,168	12.83%
	Ujë & Ujëra të zeza	14,857,872	2,831,851	19.06%

7. SHUMAT E FATURIMIT DHE ARKËTIMI NË VLERË MONETARE

Të dhënat për faturim dhe arkëtim në vlerë monetare do të paraqiten po ashtu në formë tabelore, për krahasim më të lehtë të rezultateve të arritura nga kompanitë dhe sektori gjatë nëntë mujorit të parë të vitit 2014 me ato të aprovuara nga ZRRUK për të njëjtën periudhë kohore, sipas procesit rregullatorë të përcaktimit të tarifave të viteve 2012-2014.

Edhe këto të dhëna do të paraqiten sipas shërbimeve të ofruara; veç për shërbimet e ujit dhe veç për shërbimet e kanalizimit dhe pastaj të përmbledhura do të paraqiten të dhënat e aprovuara për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi përgjatë periudhës së shikuar për nëntë mujorin e parë të vitit 2014 dhe për krahasime do të pasqyrohen edhe të dhënat e realizuara gjatë nëntë mujorit të parë të vitit 2014 me të dhënat historike për periudhën e njëjtë kohore të vitit 2013.

Sipas politikave tarifore, të cilat janë publikuar nga ZRRUK në Mars të vitit 2011, faturimi dhe arkëtimi nga tarifa fikse dhe volumetike i atribuohet shërbimeve të ujësjellësit, ndërsa tarifa volumetrike për kanalizim i atribuohet si e vetme shërbimeve të ujërave të zeza.

Duke pasur parasysh se jo të gjitha KRU-të kanë qenë në gjendje të bëjnë ndarjen e arkëtimit për ujë dhe ato për ujëra të zeza, ZRRUK ka qenë i detyruar që të bëjë këtë ndarje sipas një gjykimi i cili është konsideruar si më i arsyeshmi, për kushtet në të cilat gjendemi. Kjo ndarje është bazuar në faturimin e planifikuar sipas BPRR të aprovuar nga ZRRUK dhe ato të realizuara nga KRU-të dhe sektorit të cilit i takojnë.

Shënim:

Duhet theksuar se për KRU "Mitrovica" sh. a – Mitrovicë, Qeveria e Republikës së Kosovës ndan mjete nga Buxheti i Republikës së Kosovës çdo vit, që nga pas lufta, për të mbuluar një shumë të caktuar të shpenzimeve operative të cilat krijohen me rastin e furnizimit me ujë të pjesës Veriore të Qytetit të Mitrovicës. Në mënyrë që vlerësimi i ZRRUK-ut të jetë real, të dhënat e më poshtme i atribuohen të dy zonave të shërbimit (Jugore dhe Veriore), dhe si të tilla do të identifikohen aty ku është e mundur (faturimi e arkëtimi) për periudhat e shikuara.


7.1. Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Në këtë tabelë është paraqitur faturimi i shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare, për të dhënat historike të 9 mujorit të parë të vitit 2013, ato të aprovuara nga ZRRUK dhe të realizuara nga KRU-të dhe sektori gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2014.

Tabela Nr. 5 Pasqyra e të dhënave të faturimit për ujë dhe ujërave të zeza në vlerë monetare




Emri i Kompanisë	Të dhënat e faturimit për:	Valuta	Historike 9m2013	Aprovuara nga ZRRUK 9m2014	Realizuara nga KRU 9m2014	% Krah. 2014/2013	% e real. të cakt. 9m2014	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	8,820,209	11,874,300	7,901,510	89.58%	66.54%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	841,275	1,276,600	775,267	92.15%	60.73%	Jo e R
	Totali	€	9,661,483	13,150,900	8,676,777	89.81%	65.98%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	2,911,746	3,512,026	2,702,187	92.80%	76.94%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	303,777	426,133	270,796	89.14%	63.55%	Jo e R
	Totali	€	3,215,523	3,938,159	2,972,983	92.46%	75.49%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	2,075,961	2,711,736	2,317,106	111.62%	85.45%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	181,781	369,582	249,987	137.52%	67.64%	Jo e R
	Totali	€	2,257,742	3,081,318	2,567,093	113.70%	83.31%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë-Jugu	€	1,472,532	2,271,086	1,507,453	102.37%	66.38%	Jo e R
	Ujë-Veriu	€	529,634	599,250	444,144	83.86%	74.12%	E pa K
	Ujëra të Zeza	€	301,795	620,176	303,770	100.65%	48.98%	Jo e R
	Totali¹	€	1,774,327	2,891,262	1,811,223	102.08%	62.64%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	2,360,814	2,654,683	2,357,566	99.86%	88.81%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	297,097	454,052	299,517	100.81%	65.97%	Jo e R
	Totali	€	2,657,911	3,108,735	2,657,083	99.97%	85.47%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	1,117,365	1,239,697	1,061,438	94.99%	85.62%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	187,109	360,860	222,648	118.99%	61.70%	Jo e R
	Totali	€	1,304,474	1,600,556	1,284,086	98.44%	80.23%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	1,117,365	1,295,004	1,094,332	97.94%	84.50%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	215,207	284,027	198,313	92.15%	69.82%	Jo e R
	Totali	€	1,332,572	1,579,031	1,292,645	97.00%	81.86%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	19,875,992	26,157,781	19,385,734	97.53%	74.11%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	2,328,041	3,791,430	2,320,299	99.67%	61.20%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	22,204,033	29,949,211	21,706,033	97.76%	72.48%	Jo e R

Është e rëndësishme të theksohet se në sektorin e ujit në Kosovë, për këtë periudhë kohore, 89.31 % të shumës së faturimit realizohet nga shërbimi i ujit, ndërsa 10.69% rrjedh nga shërbimi i ujërave të zeza. Në total për sektorin, gjatë 9 mujorit të parë të vitit 2014 është realizuar faturimi në vlerë prej 21,706,033 €, e që paraqet 72.48% të shumës së aprovuar nga procesi rregullator për 9 mujorin e vitit 2014.



¹ Në këtë pikë, totali nuk përmban edhe sasinë e faturimit për pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës. Por, për të qenë të informuar palët e interesit për sasinë e ujit të faturuar për atë pjesë, ne e kemi vendosur vetëm si shifër ilustrative.

7.2 Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të zeza



Nga grafikoni vërehet se asnjëra KRU nuk ka arritur të realizoj faturimin në Euro ashtu siç është aprovuar nga ZRRUK në procesin tarifor 2012-2014, për 9 mujorin parë të vitit 2014. Si rezultat i kësaj kemi edhe të dhënat sektoriale për këta tregues të cilat i konsiderojmë jo të mira.


7.3. Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Në këtë tabelë është paraqitur arkëtimi për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare, për të dhënat historike të 9 mujorit të parë të vitit 2013, ato të aprovuara nga ZRRUK dhe të realizuara nga KRU-të gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2014 të cilat si të tilla krahasohen dhe vlerësohen sipas pasqyrës së mëposhtme.

Tabela Nr. 6 Shumat e arkëtimit për shërbimet e ujit në vlerë monetare




Emri i Kompanisë	Faturimi për shërbimet përkatëse	Njësia monet.	Historike 9m 2013	Aprovuara nga ZRRUK 9m 2014	Realizuara nga KRU 9m 2014	% krahasuese 2014/ 2013	% e real. të caktut 2014	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	6,436,690	9,196,954	6,337,989	98.47%	68.91%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	547,201	1,006,184	621,971	113.66%	61.81%	Jo e R
	Totali	€	6,983,891	10,203,138	6,959,960	99.66%	68.21%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	2,025,172	2,721,436	1,982,660	97.90%	72.85%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	211,297	328,910	198,411	93.90%	60.32%	Jo e R
	Totali	€	2,236,470	3,050,346	2,181,071	97.52%	71.50%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	1,148,084	2,028,910	1,414,094	123.17%	69.70%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	100,532	288,799	152,931	152.12%	52.95%	Jo e R
	Totali	€	1,248,616	2,317,709	1,567,024	125.50%	67.61%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	696,703	1,457,234	702,429	100.82%	48.20%	Jo e R
	Subvencionet	€	274,959	288,750	275,140	100.07%	95.29%	E pa K
	Ujërat e zeza	€	142,699	433,422	141,620	99.24%	32.67%	Jo e R
	Totali²	€	839,402	1,890,656	844,048	100.55%	44.64%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	1,738,801	2,126,008	1,813,023	104.27%	85.28%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	218,909	367,435	229,988	105.06%	62.59%	Jo e R
	Totali	€	1,957,710	2,493,443	2,043,010	104.36%	81.94%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	607,153	897,062	638,410	105.15%	71.17%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	111,166	265,866	134,590	121.07%	50.62%	Jo e R
	Totali	€	718,319	1,162,927	773,000	107.61%	66.47%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	772,178	1,060,821	729,847	94.52%	68.80%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	148,033	236,618	132,593	89.57%	56.04%	Jo e R
	Totali	€	920,212	1,297,439	862,440	93.72%	66.47%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	13,424,782	19,488,425	13,618,451	101.44%	69.88%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	1,479,838	2,927,233	1,612,104	108.94%	55.07%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	14,904,619	22,415,658	15,230,555	102.19%	67.95%	Jo e R

Për sektorin e ujit në Kosovë, sipas vlerësimeve të ZRRUK të 9 mujorit të parë të vitit 2014, 89.42% e arkëtimit rrjedh nga shërbimi i ujit, ndërsa pjesa tjetër prej 10.58% rrjedh nga shërbimi i ujërave të zeza. Në total, gjatë 9m të parë të vitit 2014 është realizuar arkëtimi në vlerë prej 15,230,055 €, e që paraqet 67.95 % të shumës së aprovuar gjatë procesit tarifor për 9m e vitit 2014.



² Subvencionet e dhëna nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të mbuluar kostot e ujit të trajtuar me shumicë për pjesën veriore të Qytetit të Mitrovicës, nuk përbëjnë totalin në këtë pikë, por ato janë vendosur vetëm si shifër ilustrative për të informuar palët e interesit.

7.4. Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të zeza



Nga grafikoni vërehet se asnjëra nga KRU-të nuk ka arritur të realizoj arkëtimin ashtu siç është aprovuar nga ZRRUK në procesin tarifor 2012-2014, për 9m e parë të vitit 2014.

Të hyrat nga subvencionet për mbulim të shpenzimeve operative në KRU “Mitrovica” sh. a. Mitrovicë për periudhën e shikuar janë 275,140 €, dhe kjo shtesë është paraqitur në përqindje me ngjyrë të gjelbër në grafikon.

8. INVESTIMET KAPITALE

Me aprovimin e tarifave të reja për periudhën afatmesme 2012-2014, ZRRUK ka paraparë që të ndërmerren investime kapitale të konsiderueshme prej të gjitha kompanive të ujësjellësit, këto investime janë të domosdoshme në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit, të cilat nëse realizohen do të mundësojnë shërbime më cilësore për konsumatorë.

Sipas UKRR-s, investimet kapitale janë klasifikuar si investime në **shërbimet ujësjellësit dhe shërbimet e kanalizimit**, të cilat klasifikohen më tej:

I. Investimet në shërbimet e ujësjellësit më pastaj janë ndarë në:

- Investime në resurse dhe trajtim të ujit,
- Investime në distribuim, dhe
- Investime në aktivitete biznesore.

II. Kurse investimet në shërbimet e ujërave të zeza janë ndarë në:

- Investime në grumbullimin e ujërave të zeza,
- Investime në trajtimin e ujërave të zeza,
- Investime në trajtimin dhe derdhjen e llumit, dhe
- Investime në aktivitete biznesore

Më pastaj, investimet në asetet e ujësjellësit dhe kanalizimit janë ndarë në: **asete të infrastrukturës dhe ato të jo-infrastrukturës**

Investimet kapitale në **Asetet Infrastrukturore** më tutje janë të ndara në investime: (i) të cilat bëhen për qëllime të përtëritjes infrastrukturës, (ii) dhe në investime të rritjes së infrastrukturës. Këto investime karakterizohen si investime në asete nëntokësore siç janë: gypat, pusetat, digat, rezervuarët nëntokësore, kanalet e ujit etj.

Investimet kapitale në **Asetet Jo-Infrastrukturore** bëjnë pjesë të gjitha investimet në asetet mbitokësore siç janë: (i) fabrikat për trajtimin e ujit, (ii) ndërtesat administrative, (iii) mjetet transportuese, (iv) pajisjet për zyrë etj. Ky grup i investimeve më pastaj kategorizohet në investime të mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes së jo-infrastrukturës.

Për t'u njoftuar më në detaje për këto kategorizime mund të gjenden shpjegime në UKRR të cilat janë të publikuara në webfaqen zyrtare të ZRRUK.

8.1. Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake

Në tabelën e më poshtme paraqiten shumat e investimeve kapitale me financim nga burimet vetanake të kompanive për kategorinë e shërbimeve të ujësjellësit gjatë 9 mujorit të vitit 2014 (vetëm ato të dhëna të regjistruara në kontabilitet). Më këtë bëhet krahasimi i shumave të investimeve kapitale të aprovuara nga ZRRUK me ato të realizuara nga KRU-të gjatë vitit 2014, % e realizimit të investimeve të planifikuara dhe vlerësimin tonë përfundimtar.

Tabela Nr. 7. Shumat e investimeve kapitale për ujë të financiar nga burimet vetanake të kompanive sipas kategorive të theksuara më lartë në 9 mujorin e parë të vitit 2014 shprehur në €

Emri i kompanisë me kategori të Investimeve Kapitale	Aprovuara 9m 2014	Realizuara 9m 2014	% e real. të cakt 2014	Vlerësimi përfundimtar
1. PRISHTINA	4,077,681	957,792	23.49%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	756,573	81,308	10.75%	Jo e R
Distribui	2,913,806	679,562	23.32%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	407,301	196,922	48.35%	Jo e R
2. HIDROREJIONI-JUGOR	223,426	173,711	77.75%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	23,643	122,252	517.08%	E realizuar
Distribui	199,783	42,290	21.17%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	9,169	!	E pa K
3. HIDRODRINI	485,162	272,341	56.13%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	!	E pa K
Distribui	482,916	226,567	46.92%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	2,246	45,774	2037.95%	E realizuar
4. MITROVICA	0	0	!	E pa K
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	!	E pa K
Distribui	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
5. RADONIQI	299,029	226,935	75.89%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	7,881	0	0.00%	Jo e R
Distribui	291,148	37,830	12.99%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	189,105	!	E pa K
6. BIFURKACIONI	87,986	147,796	167.98%	E realizuar
Resurse dhe trajtimi i ujit	28,371	0	0.00%	Jo e R
Distribui	59,614	2,969	4.98%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	144,827	!	E pa K
7. HIDROMORAVA	142,449	8,383	5.88%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	23,643	8,194	34.66%	Jo e R
Distribui	118,806	0	0.00%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	189	!	E pa K
TOTALI si e dhënë sektoriale	5,315,733	1,786,958	33.62%	Jo e R




Tabela Nr. 8. Shumat e investimeve kapitale për ujëra të zeza të financuar nga burimet vetanake të kompanive sipas kategorive të theksuara më lartë në 9 mujorin e parë të vitit 2014, shprehur në €

Emri i kompanisë me kategori të Investimeve Kapitale	Aprovuara 9m 2014	Realizuara 9m 2014	% e real. të cakt. 9m 2014	Vlerësimi përfundimtar
1. PRISHTINA	275,590	16,449	5.97%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	262,993	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	12,597	16,449	130.58%	E realizuar
2. HIDROREGJIONI-JUGOR	14,125	12,786	90.52%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	14,125	4,916	34.80%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	300	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	7,570	!	E pa K
3. HIDRODRINI	201,083	0	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	200,965	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	118	0	0.00%	Jo e R
4. MITROVICA	107,260	0	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	107,260	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
5. RADONIQI	122,503	0	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	122,503	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
6. BIFURKACIONI	156,739	0	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	156,739	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
7. HIDROMORAVA	89,152	0	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	89,152	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
TOTALI si e dhënë sektoriale	966,453	29,235	3.03%	Jo e R

Tabela Nr. 9. Shumat e Investimeve kapitale të financuara nga burimet vetanke të kompanive për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në 9 mujorin e parë të vitit 2014.

Emri i kompanisë	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Historike 2012	Aprovuara 9 mujori 2014	Realizuar 9 mujori 2014	% Krahasese e 9 mujorit 2014/ 2013	% e real. të caktut të 9m 2014	Vlerësimi përfundimtar për 9 mujorin 2014
Prishtina	Ujë	€	590,455	4,077,681	957,792	162.21%	23.49%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	9,490	275,590	16,449	173.33%	5.97%	Jo e R
	Totali	€	599,945	4,353,270	974,242	162.39%	22.38%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	160,018	223,426	173,711	108.56%	77.75%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	23,019	14,125	12,786	55.55%	90.52%	Jo e R
	Totali	€	183,037	237,551	186,497	101.89%	78.51%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	0	485,162	272,341	!	56.13%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	0	201,083	0	!	0.00%	Jo e R
	Totali	€	0	686,245	272,341	!	39.69%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	9,212	0	0	0.00%	!	E pa K
	Ujëra të zeza	€	0	107,260	0	!	0.00%	Jo e R
	Totali	€	9,212	107,260	0	0.00%	0.00%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	443,729	299,029	226,935	51.14%	75.89%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	3,055	122,503	0	0.00%	0.00%	Jo e R
	Totali	€	446,784	421,532	226,935	50.79%	53.84%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	17,632	87,986	147,796	838.23%	167.98	E realizuar
	Ujëra të zeza	€	796	156,739	0	0.00%	0.00%	Jo e R
	Totali	€	18,428	244,725	147,796	802.02%	60.39%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	16,277	142,449	8,383	51.50%	5.88%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	0	89,152	0	!	0.00%	Jo e R
	Totali	€	16,277	231,602	8,383	51.50%	3.62%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	1,237,32	5,315,733	1,786,95	144.42%	33.62%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	36,360	966,453	29,235	80.41%	3.03%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	1,273,68	6,282,186	1,816,19	142.59%	28.91%	Jo e R

8.2. Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale vetanake të kompanive nga investimet vetanake për 9 mujorin e parë të vitit 2014



8.3. Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët

Në këtë tabelë paraqiten të dhënat e shumave të aprovuara dhe realizuara nga financimet e donatorëve të cilët kanë qenë pjesë të planifikimit të projekteve për realizim të investimeve kapitale për shërbimet e ujit gjatë 9 muorit të parë të vitit 2014. Krahasimi i këtyre të dhënave pasqyron shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara për këtë periudhë kohore, të cilat epen në % me vlerësimin përfundimtarë. Edhe në këtë pasqyrë të dhënat e realizuara janë vetëm ato të regjistruara në kontabilitet.

Tabela Nr. 10. Shumat e investimeve kapitale për ujë të financiar nga donatorët sipas kategorive të theksuara më lartë në 9 muorin e parë të vitit 2014 shprehur në €.

Emri i kompanisë me kategori të Investimeve Kapitale	Aprovuara 9m 2014	Realizuara 9m 2014	% e real. të cakt 2014	Vlerësimi përfundimtar
1. PRISHTINA	2,081,365	0	0.00%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	!	E pa K
Distribuim	2,081,365	0	0.00%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
2. HIDROREGJIONI-JUGOR	86,691	235,286	271.41%	E realizuar
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	235,286	!	E pa K
Distribuim	86,691	0	0.00%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
3. HIDRODRINI	165,500	49,769	30.07%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	!	E pa K
Distribuim	165,500	0	0.00%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	49,769	!	E pa K
4. MITROVICA	0	0	!	E pa K
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	!	E pa K
Distribuim	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
5. RADONIQI	118,215	285,268	241.31%	E realizuar
Resurse dhe trajtimi i ujit	118,215	38,190	32.31%	Jo e R
Distribuim	0	211,996	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	35,082	!	E pa K
6. BIFURKACIONI	236,429	0	0.00%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	!	E pa K
Distribuim	236,429	0	0.00%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
7. HIDROMORAVA	0	0	!	E pa K
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	!	E pa K
Distribuim	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
TOTALI	2,688,200	570,323	21.22%	Jo e R




Tabela Nr. 11. Shumat e investimeve kapitale për ujëra të zeza të financuara nga donatorët sipas kategorive të theksuara ma lartë në 9 mujorin e parë të vitit 2014 shprehur në €.

Emri i kompanisë me kategori të Investimeve Kapitale	Aprovuara 9m 2014	Realizuar 9m 2014	% e real. të cakt 2014	Vlerësimi përfundimtar
1. PRISHTINA	0	0	!	E pa K
Grumbullimi i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
2. HIDROREGJIONI-JUGOR	425,572	0	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	425,572	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
3. HIDRODRINI	8,629,664	17,314	0.20%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	1,576,194	17,314	1.10%	Jo e R
Trajtim i u.z	7,053,470	0	0.00%	Jo e R
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
4. MITROVICA	64,624	0	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	64,624	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
5. RADONIQI	0	0	!	E pa K
Grumbullimi i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
6. BIFURKACIONI	0	0	!	E pa K
Grumbullimi i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
7. HIDROMORAVA	0	0	!	E pa K
Grumbullimi i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
TOTALI	9,119,861	17,314	0.19%	Jo e R

Tabela Nr. 12. Shumat e investimeve kapitale të aprovuar dhe realizuar nga donatorët për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza gjatë 9 mujorit të parë të vitit 2014

Emri i kompanisë	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Historike 9m 2013	Aprovuara nga ZRRUK 9m 2014	Realizuar nga KRU 9m 2014	% krahasues 2014/ 2013	% e real. të caktut 2013	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	0	2,081,365	0	!	0.00%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	0	0	0	!	!	E pa K
	Totali	€	0	2,081,365	0	!	0.00%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	210,232	86,691	235,286	111.92%	271.41	E realizuar
	Ujëra të zeza	€	15,004	425,572	0	0.00%	0.00%	Jo e R
	Totali	€	225,236	512,263	235,286	104.46%	45.93%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	0	165,500	49,769	!	30.07%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	0	8,629,664	17,314	!	0.20%	Jo e R
	Totali	€	0	8,795,165	67,083	!	0.76%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	0	0	0	!	!	E pa K
	Ujëra të zeza	€	0	64,624	0	!	0.00%	Jo e R
	Totali	€	0	64,624	0	!	0.00%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	547,606	118,215	285,268	52.09%	241.31	E realizuar
	Ujëra të zeza	€	0	0	0	!	!	E pa K
	Totali	€	547,606	118,215	285,268	52.09%	241.31	E realizuar
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	0	236,429	0	!	0.00%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	0	0	0	!	!	E pa K
	Totali	€	0	236,429	0	!	0.00%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	0	0	0	!	!	E pa K
	Ujëra të zeza	€	0	0	0	!	!	E pa K
	Totali	€	0	0	0	!	!	E pa K
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	757,838	2,688,200	570,323	75.26%	21.22%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	15,004	9,119,861	17,314	115.40%	0.19%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	772,842	11,808,060	587,637	76.04%	4.98%	Jo e R

8.4. Paraqitja grafike e të dhënave të regjistruara në kontabilitet për investimet kapitale nga donatorët gjatë 9 mujorit të parë të vitit 2014



9. KONKLUZIONET E RAPORTIT

Nga ajo që u theksua ma lartë, duhet theksuar se qëllimi i këtij raporti është të sensibilizoj të gjithë akterët në sektorin e ujit për ecurinë e përmbushjes /mos përmbushjes së caqeve të përcaktuara në procesin tarifor për gjashtë mujorin e parë të vitit 2014. Siç dihet, objektivat e përcaktuara nga ZRRUK me KRU-të, paraqesin “Marrëveshje - Kontraktuale” për të cilat KRU-të janë të obliguara të punojnë në përmbushjen e tyre pasi që të njëjtat kanë ngarkuar tarifat e aplikuara. Konkluzionet e këtij raporti përshkruajnë të dhënat sektoriale me ndonjë specifikë për KRU-të.

Te dhënat operative

Sa i përket të dhënave operative në baza sektoriale nga katër indikatorët që janë marrë në shqyrtim dy prej tyre janë vlerësuar pozitivisht dhe dy negativisht. Sasia e ujit të prodhuar është vlerësuar negativisht ngase sasia e prodhuar është më e vogël se sasia e aprovuar nga ZRRUK, sikurse e që është vlerësuar negativisht edhe sasia e ujit të faturuar. Ndërsa sasia e ujit të humbur është më e vogël nga sasia e pranuar nga rregullatori dhe për këtë vlerësimi është pozitiv, sikur edhe për numrin e konsumatorëve ku kemi tejkalim në krahasim me parashikimet me biznes planet rregullatore për periudhen e shikuar.

Shpenzimet operative

Përpos KRU “Mitrovica” që ka arritur të mbajë në kontroll shpenzimet operative për këtë periudhë kohore, të gjitha KRU-të tjera kanë shpenzuar më shumë se sa u është aprovuar nga Rregullatori dhe që të gjitha janë vlerësuar “TN” (tejkualuar negativisht). Njëhrit tërheqim vërejtjen për ngritjen e theksuar te fondit te pagave te disa nga kompanitë gjate periudhe se shikuar ne krahasim me te dhënat e njëjta te vitit 2013 të cilat konsiderojmë se po bëhen në dëm të zërave tjerë të kostove për investime kapitale vetanake..

Faturimi në vlerë monetare

As një nga kompanitë nuk ka arrit të realizojë e as të përafrojë shumën e faturimit të aprovuar për periudhën e shikuar kohore . Pasi që as një nga kompanitë nuk ka realizuar shumën e akorduar të faturimit, vlerësuar i tyre është si “Jo e R” (jo e realizuar), si vlerësim i përgjithshëm **negativ**.

Arkëtimi në vlerë monetare

Të gjitha KRU-të që operojnë në Kosovë, janë larg realizimit të shkallës së arkëtimit krahasuar me atë që është aprovuar nga Rregullatori për këtë periudhë kohore. Mund të themi se më e angazhuarit në këtë drejtim kanë qenë; KRU “Radoniqi” sh. a. Gjakovë, duke e arrit shkallën e inkasimit për periudhën e shikuar kohore në masën prej 81.94%. Të gjitha KRU-të duhet të angazhohen më shumë në përmirësimin e shkallës së arkëtimit. As një nga kompanitë nuk ka realizuar shumën e akorduar të faturimit, prandaj janë vlerësuar si “Jo e R” (jo e realizuar) si vlerësim i përgjithshëm **negativ**.

Investimet Kapitale

Çështja e Investimeve Kapitale vazhdon të mbetet njëra ndër pikat më të dobëta për t’u realizuar nga KRU-të në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe kohore asnjëra prej KRU-ve nuk ka arritur të investojë shumën e investimeve që u është aprovuar nga Rregullatori. ZRRUK shpreson se gjatë pjesës së mbetur të këtij viti, KRU-të të mobilizohen edhe më shumë në mënyrë që të realizojnë investimet prej

burimeve financiare vetanake të tyre si dhe ti bëjnë të gjitha regjistrimet e nevojshme nëse projektet realizohen në librat e regjistrimit kontabël.

Te dhënat e raportit dëshmojnë se edhe pse kemi ndonjë tregues pozitivë, kompanitë dhe sektori janë akoma larg përmbushjes së objektivave të përcaktuara për të cilat duhen angazhime shtesë të menaxhmenteve të tyre, të cilat edhe në vijim do të monitorohen.